Qëllimi i përgjithshëm i kësaj mase është zgjerimi i mbulimit, gjithëpërfshirjes, efektivitetit dhe shënjestrimit më të mirë të individëve në nevojë, me shërbime të integruara sociale dhe mekanizmave financiarë: fondit social dhe ndërmarrjeve sociale.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet: i. shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale; ii. të

fuqizohen njësitë e qeverisjes vendore për të përfshirë shërbimet dhe mekanizmat e duhur të kujdesit social në planet e tyre të politikave sociale; iii. vazhdimësisë së zbatimit të planit kombëtar të veprimit për deinstitucionalizimin; iv. rishikimit të standardeve minimale ekzistuese për 17 shërbime të kujdesit social dhe identifikimi i standardeve të reja funksionale dhe strukturore sipas nevojës; v. hartimit të një metodologjie dhe përcaktimit të kostos për njësi për shërbimet e kujdesit social, bazuar në standardet minimale strukturore dhe të funksionimit; vi. zhvillimit të metodologjisë për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit social kombëtar, duke marrë parasysh masat që adresojnë përmirësimin e transparencës dhe barazisë vertikale dhe horizontale.

Bazuar në vlerësimin e ecurisë së nivelit të përfitimit të ndihmës ekonomike, do të vendoset një mekanizëm transparent për rishikimin e rregullt të saj

Është ngritur një mekanizëm koordinues ndërinstitucional në nivel qendror, me ekipe pune në nivel rajonal dhe vendor për referimin dhe punësimin e individëve dhe anëtarëve në moshë pune të familjeve që përfitojnë ndihmë sociale. Këto struktura do të sigurojnë riintegrimin social, nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të një programi të daljes nga skema e ndihmës ekonomike. Është miratuar programi i daljes dhe plani i veprimit, me qëllimin për të nxitur integrimin shoqëror të familjeve nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, në mënyrë që kjo skemë të mos përdoret si mjet përfitimi që mund të çojë drejt papunësisë së zgjatur të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe ta kthejë atë në një skemë aktive.

Aktualisht, është përgatitur udhërrëfyesi me hapat dhe afatet kohore për rregullimin e përfitimeve të ndihmës ekonomike dhe vendosjen e një mekanizmi transparent për rishikimin e rregullt vjetor të tyre, në përputhje me kushtin e asistencës makrofinanciare të BE-së për Shqipërinë.

Hapat e udhërrëfyesit, sipas angazhimit, do të zbatohen deri në fund të vitit 2024. Hapat përfshijnë analizën e performancës së përfitimit të ndihmës ekonomike, duke përdorur të dhënat më të fundit të HBS-së dhe EU-SILC dhe krijimin e një mekanizmi për të përditësuar rregullisht nivelin e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Me ligjin 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", u hoq një kufizim i mëparshëm, për të garantuar që përfitimet e fituara për shkak të aftësisë së kufizuar të mos ndërpriteshin, në rast punësimi për personat me aftësi të kufizuara, një hap drejt përfshirjes dhe integrimit social.

Në kuadër të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale, qeveria ka miratuar dokumentet strategjike: Strategjia për Barazinë Gjinore 2021–2030; Plani Kombëtar për Personat LGBTI; Plani Kombëtar i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021–2025; Plani Kombëtar për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025 dhe Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.

Ndërhyrjet konkrete synojnë:

i. krijimin e një mekanizmi për të rishikuar masën e përfitimit të ndihmës ekonomike;

ii. forcimin e kapaciteteve administrative të qeverisjes vendore për sektorin social, veçanërisht për të aplikuar për mbështetje nga fondi social dhe për të planifikuar, administruar dhe ofruar shërbime të reja të kujdesit social. Bazuar në një metodologji të re, në lidhje me vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit social kombëtar, shërbimet sociale në territor duhet t'u përgjigjen më mirë nevojave të grupeve vulnerabël;

iii. mbështetjen e personave nga grupet e pafavorizuara me punësim në ndërmarrjet sociale, në zbatim të legjislacionit për ndërmarrjet sociale dhe akteve nënligjore, si mjet për riintegrimin e personave nga grupet vulnerabël. Nga kjo masë kanë përfituar statusin e ndërmarrjeve sociale 8 organizata, të cilat janë parashikuar të punësojnë 80 persona nga grupet vulnerabël;

iv. mbështetjen për të vazhduar aksesin në shërbimet e mbështetjes sociale edhe në rrethanat e reja të krijuara nga COVID-19 për gratë, burrat, vajzat, djemtë dhe fëmijët vulnerabël, që rrezikojnë të mbeten pas.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022-shin

a) Krijimi i mekanizmit për përditësimin e rregullt të nivelit të përfitimit të NE-së;

b) Zbatimi i sistemit të vlerësimit biopsikosocial për personat me aftësi të kufizuara me mbështetje në para dhe kujdes shoqëror në katër qarqe;

c) Mbështetje për personat nga shtresat e disavantazhuara, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i 5 ndërmarrjeve sociale;

d) Përmirësimi dhe zgjerimi i ofrimit të shërbimeve sociale të integruara me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore për të gjitha kategoritë në nevojë në kuadër të fondit social;

e) Vlerësim i gjithë institucioneve publike të kujdesit rezidencial dhe zhvillimi i planit të transformimit të tyre;

f) Krijimi i një qendre mbështetëse dhe miqësore për fëmijët në Tiranë, Shkodër dhe Durrës, bazuar në pilotimin aktual në Korçë dhe Vlorë;

g) Zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë nëpërmjet politikëbërjes dhe treguesve të përmirësuar.

b) Aktivitete të planifikuara më 2023-shin

a) Rregullimi i përfitimeve të ndihmës ekonomike;

b) Zgjerimi i zbatimit të sistemit të vlerësimit biopsikosocial për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara, me mbështetje të kombinuar në para dhe kujdes social në rajone të tjera;

c) Mbështetje për personat nga shtresat në nevojë, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i ndërmarrjeve sociale.

c) Aktivitete të planifikuara më 2024-ën

a) Zgjerimi i zbatimit të skemës së vlerësimit biopsikosocial për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara me mbështetje të kombinuar në para dhe kujdes social në qarqe të tjera;

b) Mbështetje për personat nga shtresat e pafavorizuara, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i ndërmarrjeve sociale;

c) Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë në nevojë, në kuadër të fondit social;

d) Finalizimi i transformimit për të gjitha shërbimet rezidenciale, njëkohësisht transformimi i avancuar i institucioneve rezidenciale jopublike;

e) Zbatimi i Planeve Kombëtare të Veprimit për përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë nëpërmjet politikëbërjes dhe treguesve të përmirësuar.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë (2021)	I ndërmjetëm (2023)	Synimi (2024)
% e popullsisë të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi social	46.2% (2019)	45%	44%
Numri i shërbimeve të reja sociale për grupet e pafavorizuara të ofruara nëpërmjet njësive të qeverisjes vendore duke përdorur burime nga fondi social	19	30 (kumulative)	45 (kumulative)
Numri i personave vulnerabël të punësuar në ndërmarrjet sociale	N/A	100 (kumulative)	150 (kumulative)

3. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2022 është 209,584,879 euro;

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2023 është 216,679,174 euro;

Buxheti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale për vitin 2024 është 216,499,794 euro.

Nga ky buxhet, për vitin 2022, fondi për pagesën e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar vlerësohet në 177 920 686 euro.

Financimi për fondin social përllogaritet në 1,6 milionë euro dhe për ndërmarrjet sociale 1 milionë euro.

Nga IPA (IPA 2019/04 l-203/Shqipëri/BE për përfshirjen sociale është vlerësuar një fond për Fondin social 1 milionë euro për vitin 2022 dhe 1.5 milionë për 2023-shin

4. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale si punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Përmirësimi i situatës socio-ekonomike të kategorive në nevojë, ndikimi i drejtpërdrejtë në zbutjen e varfërisë, duke rritur nivelin e përfitimit të ndihmës ekonomike. Rritja e aksesit në paketën bazë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

5. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Masa e reformës nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

6. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Kapacitete të munguara apo të ulëta në nivel vendor për hartimin e planeve të detajuara sociale.	I ulët	Bashkëpunimi me aktorët lokalë për ngritjen e kapaciteteve për plane sociale
Rritja e nivelit të varfërisë përtej parashikimeve për shkak të krizave të COVID-19	I lartë	Rishikimi i përfitimeve të ndihmës sociale

Masa e reformës 05: Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor

1. Përshkrimi i masës

Shëndeti për të gjithë mbetet synimi ynë kryesor. Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor dhe ofrimi i një kujdesi shëndetësor të sigurt dhe të barabartë në të gjitha nivelet e sistemit publik dhe jo vetëm, mbetet një nga objektivat kryesorë të qeverisë shqiptare. Ky objektiv është në përmbajtje të gjithë dokumenteve e politikave që janë në proces zbatimi, hartimi dhe buxhetimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga viti 2013 e në vazhdim.

Ka pasur rritje progresive të buxhetit të dedikuar për shëndetësinë. Në vitin 2021 buxheti i dedikuar për shëndetësinë është 63.7 miliardë lekë ose 10.6% e buxhetit të shtetit dhe 3.6% e PBB-së (krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 0.3% të PBB-së). Buxheti për vitin 2021 është 20.8% më i lartë se buxheti i shëndetësisë për vitin 2020 dhe 79.1% rritje krahasuar me vitin 2013. Shpenzimet për shëndetësi për frymë janë rritur nga 12,295 lekë më 2013-ën në 22,410 më 2021-shin me një rritje prej 82.3%.

Kontributet e kujdesit shëndetësor në vitin 2021 arrijnë në 14,084 milionë lekë dhe projeksioni për tri vitet e ardhshme është një rritje progresive vjetore të kontributeve shëndetësore mesatarisht 7%. Projeksioni është që në vitin 2022 kontributet shëndetësore të jenë 15,096 milionë lekë, në vitin 2023 kontributet 15,151 milionë lekë dhe në vitin 2024 do të jenë në masën 17,172 milionë lekë ose një rritje prej 21,78% krahasuar me vitin 2021.

Kujdesi shëndetësor në Shqipëri është tashmë në procesin e transformimit dhe modernizimit të vazhdueshëm. Objektivi ynë është të ofrojmë një ofertë shëndetësore të barabartë, të aksesueshme dhe të qëndrueshme pavarësisht nga statusi social dhe ekonomik, mosha, duke filluar nga lindja e deri tek të moshuarit.

Nga viti 2017, qeveria shqiptare ka zhvilluar një Program Kombëtar për Rindërtimin e të gjitha objekteve të kujdesit shëndetësor. Deri në vitin 2021, përmes këtij programi, 300 objekte të kujdesit parësor shëndetësor jo vetëm që u transformuan për sa u përket punimeve civile, por edhe u pajisën me pajisje të reja mjekësore. Programi do të vijojë të zbatohet edhe gjatë viteve në vazhdim, duke synuar transformimin e të gjitha objekteve të kujdesit shëndetësor parësor në vend brenda vitit 2025.

Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve tumorale do të vazhdojë të mbetet prioritet në fushën e shëndetit publik. Synimi është zgjerimi i tri programeve ekzistuese *Check Up,* Programet e Kancerit të Gjirit dhe Kancerit të Qafës së Mitrës, jo vetëm për kategoritë e grup-moshave, por edhe në lidhje me terapitë e trajtimit, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Synimi është që brenda vitit 2025 vaksina HPV të jetë pjesë e Programit Kombëtar për Kancerin e Qafës së Mitrës, aktivitet ky që do të bëhet i mundur nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Institutin e Shëndetit Publik dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Nga viti 2013 e deri më tani është përfshirë në listën e barnave me rimbursim 214 barna të reja dhe është rritur me 25% fondet e dedikuara rimbursimin e barnave nga lista, duke garantuar jo vetëm një paketë të plotë barnash që ofrohet falas për të gjithë qytetarët me sëmundje kronike, por edhe një listë me terapi inovative, për të cilat 8 vjet më parë qytetarët kishin koston nga buxheti i tyre familjar.

Është trefishuar financimi i barnave për trajtimin e pacientëve me kancer dhe tashmë garantojmë trajtim 100% falas me barna për pacientët me kancer gjiri dhe kancer malinj të gjakut.

Brenda vitit 2023 synohet ndryshimi i hartimit të Listës së Rimbursimit të Barnave, duke zhvendosur fokusin nga rimbursimi i barit si produkt në rimbursimin e protokollit të trajtimit të diagnozave, për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të pacientëve, teknologjitë dhe risitë në Shërbimin Farmaceutik.

Sistemi i gjurmueshmërisë së barnave do të jetë një tjetër aktivitet që do të zhvillohet brenda vitit 2023 me synim rritjen e disponueshmërisë së barnave dhe garantimin e një monitorimi të plotë të barnave që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë.

Për herë të parë në vitin 2018 është përfshirë në skemën e rimbursimit edhe rimbursimin e pajisjeve mjekësore. Dhe, që nga viti 2018, të gjithë fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 25 vjeç përfitojnë falas fishat e diabetit.

Me synimin e mbulimit universal për fëmijët 0–18 vjeç më 2019ën u zgjerua numri i vaksinave në Programin Kombëtar të Imunizimit dhe Vaksinimit, duke përfshirë vaksinën e Rotavirusit dhe synimin për të vazhduar mbështetjen për forcimin e programit për të mbrojtur mbulimin me vaksinim në 98%.

Për më tepër, do të vazhdohet mbështetja financiare për çdo familje që sjell në jetë një fëmijë me programin dedikuar të *Baby Bonus,* nga i cili që nga fillimi i programit në 2019 janë rreth 100 mijë familje që kanë përfituar bonusin financiar të tremujorin e parë të jetës së të porsalindurit.

Në drejtim të përmirësimit të shëndetit të popullatës do të vazhdohet financimi dhe shtimi i paketave shëndetësore, me synim rritjen e aksesit në trajtime mjekësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore të shtuara pranë vendbanimit.

Nga buxheti i shtetit mbulohen plotësisht mbi 85% e nevojave të popullsisë për trajtimin e diagnozave kardiovaskulare dhe veshkave dhe synohet rritja e mbulimit me 5% deri në fund të vitit 2024, duke zgjeruar paketat me paketat e dedikuara shëndetësore për rehabilitimin, kujdesi paliativ dhe geriatrik.

Gjatë këtyre 8 viteve është investuar në modernizimin e rrjetit të Spitalit Obstetrik Gjinekolog, duke filluar me punimet civile dhe pajisjet e reja mjekësore në SUOGJ "Koço Gliozheni", SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", spitalet e reja obstetrike dhe gjinekologe në Berat, Kukës, Sarandë, Lezhë. Në Korçë kanë vijuar investime të mëdha dhe në Spitalet Pediatrike Nënë Tereza, Durrës dhe Elbasan.

Synimi është që brenda vitit 2024 të jenë ngritur 4 pole spitalore rajonale që do të krijohen në qendrat referuese të diagnostifikimit dhe të trajtimit, si dhe të krijohet dhe të funksionojnë plotësisht 10 qendra të mjekësisë familjare që do të ofrojnë shërbime të integruara sociale dhe shëndetësore me fokus në shëndeti mendor, shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë si dhe kujdesi paliativ.

Pandemia e COVID 19 testoi të gjitha nivelet e sistemit. Me mbështetjen e OBSH-së u përgatitën 4 dokumente strategjike,si udhërrëfyes i qasjes sonë të integruar për të menaxhuar pandeminë dhe për t'u siguruar që sistemi ynë shëndetësor publik të ofrojë akses në kohë për shërbimin e kujdesit shëndetësor duke filluar nga parandalimi, diagnostikimi, trajtimi dhe vaksinimi.

Në kohë rekord u transformuan 4 spitale në spitale COVID–19, nga këto dy u krijuan për herë të parë si spitale. Është dyfishuar numri i ventilatorëve dhe njësive të ICU-së, si dhe u rritën katër herë kapacitetet laboratorike për testim. Mbështetje e veçantë financiare është ofruar nëpërmjet mekanizmit të bonusit prej 1000 eurosh mbi pagën për të gjithë personelin mjekësor dhe 500 euro mbi pagën për personelin ndihmës.

Nga marsi i vitit të kaluar e deri më tani rreth 4000 personel mjekësor kanë përfituar 1000 euro bonus dhe mbi 1200 staf ndihmës kanë përfituar 500 euro bonus mbi pagën.

Mbështetja financiare për personelin mjekësor dhe për personelin ndihmës do të vazhdojë të ofrohet deri në përfundimin e pandemisë së COVID-19.

Gjatë këtij viti të pandemisë, kemi investuar dhe përgatitur njësitë e kujdesit të kujdesit shëndetësor dhe pavijonet e sëmundjeve infektive në 11 spitalet rajonale për të qenë gati për çdo lloj emergjence.

Gjatë këtij katërvjeçari do të vazhdohet të garantohen dhe ofrohen shërbime shëndetësore që mbulohen 100% nga buxheti i shtetit, duke filluar nga diagnozat e deri te fuqizimi i rrjetit laboratorik publik me pajisje dhe pajisje të reja mjekësore për të garantuar në sektorin spitalor publik të gjitha analizat mjekësore. Trajtimi nëpërmjet paketës së dedikuar të Listës së Rimbursimit të Barnave për të gjithë pacientët që janë të infektuar nga SARS–COV–2, si dhe një paketë të plotë trajtimi sipas praktikave dhe protokolleve më të mira ndërkombëtare për të gjithë pacientët tanë që do të kenë nevojë për trajtim spitalor.

Brenda vitit 2022 do të jetë përfunduar modernizimi i infrastrukturës së Spitalit tonë të Sëmundjeve Infektive në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza" në Tiranë, që do të garantojë jo vetëm një transformim të plotë të kujdesit spitalor për qytetarët tanë, por edhe dyfishimin e njësive të ICU-së.

Në një kohë rekord është arritur të të garantohen rreth 3 milionë doza vaksinash dhe deri në fund të pranverës, përmes mekanizmit COVAX dhe kontraktimit të drejtpërdrejtë me prodhuesit dhe shpërndarësit e autorizuar do të garantohen 5 milionë doza për të nisur edhe aplikimin e dozës së tretë dhe doza dhe për fëmijët nën 18 vjeç sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe ICDC-së.

Shëndeti do të vazhdojë të mbetet një e mirë publike dhe për këtë arsye deri në vitin 2030 synohet rritja e financimit publik për shëndetësinë në 70%, duke garantuar që asnjë familje shqiptare të mos bjerë në varfëri për shkak të kostove shëndetësore.

Gjatë këtyre 8 vjetëve i është kthyer dinjiteti i personelit mjekësor. Sot një mjek ose një infermier që është i punësuar në një spital publik ka një pagë 63% më të lartë se në vitin 2013. Një mjek i përgjithshëm ose një infermier në qendrën e kujdesit shëndetësor parësor ka një pagë 68% më të lartë se në vitin 2013. Do të vazhdohet edhe gjatë këtij katërvjeçari për të zbatuar politikën për rritjen e pagave deri në 40% për personelin mjekësor.

Brenda vitit 2025 do të përfundohet testimi dhe modernizimi i rrjetit laboratorik publik në 10 spitale rajonale dhe bashkiake, duke garantuar një rritje prej 20% të qytetarëve, që do të përfitojnë nga ekzaminimet laboratorike, rritjen e kapaciteteve diagnostikuese në 10 spitale bashkiake, rajonale dhe universitare, nëpërmjet investimit në pajisje mjekësore, ngritja e 3 qendrave rajonale të ekselencës në ofrimin e kujdesit për sëmundjet akute ishemike, si dhe investime të mëdha do të bëhen edhe në modernizimin e institucioneve të shëndetit mendor.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022–2024

a) Financimi i këtij lloji të kujdesit shëndetësor (të tri nivelet e sistemit primar, sekondar dhe terciar);

b) Rritja e kostos – efikasitetit të listës së barnave të rimbursimit dhe rishikimi i legjislacionit kombëtar për barnat dhe shërbimet farmaceutike;

c) Vazhdimi i financimit të 12 paketave të kujdesit shëndetësor të ofruara në spitalet publike dhe private dhe rritja e numrit të përfituesve me 5% në bazë vjetore;

d) Rishikimi i ligjit për spitalet dhe metodologjia e kostos së shërbimeve të kujdesit shëndetësor me qëllim përmirësimin e mekanizmit të financimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor;

e) Vazhdimi i financimit të programeve të depistimit parandalues dhe rritja deri në 10% të numrit të përfituesve;

f) Politikat e dedikuara për profesionistët e kujdesit shëndetësor parashikojnë praktikën e dyfishtë dhe klasifikimin e pagave, sipas treguesve të performancës;

g) Krijimi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, si një pagues i vetëm dhe transformimi gradual i financimit të spitaleve nga buxheti historik në paketat e shërbimit shëndetësor;

h) Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2025 dhe plani i veprimit i buxhetuar.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë	I ndërmjetëm	Synimi
Numri i qytetarëve që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shëndetësor publik	93%	95%	97%
Numri i qytetarëve që përfitojnë nga 12 paketat e kujdesit shëndetësor dhe 3 programet kombëtare të depistimit të financuara 100% nga buxheti i shtetit	+5%	+5%	+5%

3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Veprimet e parashikuara kanë disa dimensione ndikimi, të tilla si zbatimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor publik, rritja e aksesit, diversifikimi i ofrimit të shërbimeve, duke futur modele të reja inovative të kujdesit shëndetësor (shërbimet e banimit, vullnetare dhe me bazë komunitare) me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve me theks të veçantë në cilësinë e lartë, të arritshëm dhe të përballueshëm.

4. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2022 është 63.5 miliardë lekë ose 3.4% e PBB-së dhe 9.96% e buxhetit të shtetit.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2023 është 60 miliardë lekë ose 3.1% e PBB-së dhe 9.6% e buxhetit të shtetit.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2024 është 62 miliardë lekë ose 3% e PBB-së dhe 9.4% e buxhetit të shtetit.

5. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale, si: punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Reformat në shëndetësi synojnë të moshuarit, gratë, fëmijët, të varfrit dhe personat me aftësi të kufizuara. Masa e reformës pritet të përmirësojë mirëqenien e qytetarëve, duke ofruar shërbime shëndetësore falas me qëllim arritjen e mbulimit universal shëndetësor.

6. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Masa e reformës nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

7. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Kufizimet për shkak të pandemisë COVID-19	I mesëm	Një planifikim i kujdesshëm në nivelin qendror
Vonesat në aktivitete specifike, veçanërisht në lidhje me rimodelimin e financimit të kujdesit shëndetësor	I mesëm	Një ekip që ka nisur punën për zhvillimin e një plani të detajuar
Mungesa e vullnetit politik	I ulët	Një angazhim i niveleve më të larta të qeverisjes dhe përfshirja e të gjithë partnerëve të mundshëm në këtë sektor

Sfida kyçe #3

Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe klimës së investimeve, duke rritur mbështetjen e qeverisë dhe duke trajtuar informalitetin

a) Analiza e pengesave kryesore

Sektori privat i Shqipërisë përbëhet kryesisht nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME), të cilat kanë një barrë informaliteti. Shqipëria nisi një fushatë në mbarë vendin për të luftuar ekonominë informale në vitin 2016 dhe numri i tatimpaguesve të regjistruar dhe kontribuuesve socialë u rrit ndjeshëm. Që nga viti 2019, qeveria ka zbatuar një metodë të bazuar në risk për të përqendruar veprimin e saj në ekonominë informale, në një mënyrë më efikase dhe për ta zhvendosur fokusin larg mobilizimit të të ardhurave shtesë të buxhetit, duke rritur numrin e kontrolleve dhe inspektimeve.

Me gjithë përparimin e kohëve të fundit duke rritur numrin e bizneseve të regjistruara, ato ndonjëherë ende nuk deklarojnë tatimet apo punonjësit dhe kryejnë transaksione me para në dorë. Bizneset informale përgjithësisht kanë rendiment më të ulët se bizneset formale, gjë që është një barrë, si për bizneset, ashtu edhe për ekonominë. Të ardhurat publike reduktohen nga veprimtaria e fshehur ekonomike, duke rezultuar në pakësimin e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve publike. Biznesi i kryer jashtë ekonomisë së rregulluar sjell probleme për sigurinë, shëndetin, mbrojtjen sociale dhe rreziqet mjedisore për punëtorët dhe komunitetet. Informaliteti pengon jo vetëm zhvillimin e atyre bizneseve që vendosin të mbeten informale, por është, gjithashtu, një pengesë për kompanitë formale që ndeshen me konkurrencën nga sektori informal. Duke qenë jashtë ekonomisë formale, këto kompani nuk kanë mundësinë për të përfituar nga aksesi në financat formale, aksesi në tregjet formale dhe nga mbrojtja ligjore e pronës, kontratave dhe investimeve të tyre. Për të lejuar bizneset të kontribuojnë më mirë në ekonomi është e rëndësishme që qeveria të vazhdojë të investojë në mënyrë thelbësore në formalizimin e këtyre MSME-ve.

Qeveria shqiptare është e vendosur t'i shërbejë qeverisjes së mirë të bizneseve, si dhe reduktimit të metodës korruptuese në disa aspekte në luftën kundër evazionit dhe informalitetit. Gjatë periudhës 2020–2021, qeveria shqiptare u përfshi në një proces shumë të rëndësishëm lidhur me ligjin e fiskalizimit, i cili do të ndihmojë drejtpërdrejt administratën tatimore për të marrë të dhëna në kohë reale dhe të sakta, për të gjitha transaksionet e biznesit me administratën tatimore, por edhe të gjithë informacionin që qarkullon në marrëdhëniet "biznes me biznes" dhe "biznes me qeverinë".

I gjithë procesi i informacionit nëpërmjet faturimit tashme është elektronik dhe kjo do të ushtrojë një presion edhe më të madh ndaj aksesit në deklarimet reale financiare dhe atyre jofiskale, që sot ne i konsiderojmë të jenë larg realitetit.

Faza e parë e zbatimit të fiskalizimit, e cila konsiston në transaksione pa para të gatshme ndërmjet tatimpaguesve dhe subjekteve publike (B2G) ka nisur më 1 janar 2021; faza e dytë e transaksioneve pa para ndërmjet tatimpaguesve (B2B) ka filluar më 1 korrik 2021, ndërsa më 1 shtator 2021 ka nisur faza e fundit për transaksionet me para në dorë tatimpagues-konsumator (B2C). Të dhënat në dispozicion janë si vijon:

1. Rreth 59.000 tatimpagues aktivë të fiskalizuar dhe mbi 126 milionë fatura të fiskalizuara që prej datës 1 janar 2021.

2. 88.609 tatimpagues ose 73% e totalit të tatimpaguesve aktivë janë pajisur me certifikatë fiskalizimi.

3. 21.878 tatimpagues ose 86.4 % e tatimpaguesve aktivë biznes i madh (BM) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 18.643 tatimpagues aktivë BM ose 73.6 % e totalit të BM kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

4. 64.698 tatimpagues ose 71.1% e tatimpaguesve aktivë biznes i vogël (BV) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 37.654 ose 41.4% e tatimpaguesve aktivë BV kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

Administrata tatimore do të jetë e angazhuar në luftën kundër informalitetit për të garantuar zbatimin korrekt të procedurave tatimore. Tatimpaguesit mospërmbushës do të evidentohen nga analiza e riskut dhe do të përfshihen dhe struktura të tjera në verifikimin dhe kontrollimin e tyre për të garantuar përmbushjen e detyrimeve tatimore që të forcohet besimi i tatimpaguesve përmbushës dhe i publikut ndaj administratës tatimore.

Për vitin 2022 do të miratohet plani i përmbushjes që do të fokusohet në sektorët me një rëndësi të veçantë në ekonomi, si: turizmi, subjekte kafe-restorante, ndërtimi dhe pagat.

Gjithashtu, për vitin 2022, do të mbahet parasysh identifikimi dhe analizimi i sjelljeve deviante nga subjektet që tentojnë të përfitojnë nga pragjet tatimore (skema feniks, nëndeklarim i shitjeve, mosdeklarim i blerjeve etj.)

Në vitin 2021, në kuadër të luftës kundër informalitetit administrata tatimore hartoi dhe zbatoi:

1. Planin sektorial të turizmit 2021, me këto arritje:

i. për të njëjtët tatimpagues që kanë qenë aktiv dhe në vitin 2019, gjatë sezonit turistik të vitit 2021 është shënuar një rritja e TVSH-se së detyrueshme për t'u paguar me 15%;

ii. është kryer regjistrimi në përgjegjësinë e TVSH-së për 175 tatimpagues;

iii. rritje me 8% e numrit të punonjësve për tatimpagues aktiv në të dyja periudhat 2021–2020;

iv. rritje me rreth 16% e numrit të punonjësve të deklaruar për popullatën e targetuar aktive (për totalin e TP-së).

2. Planin sektorial të rindërtimit

Duke marrë shkas nga lehtësitë e krijuara nga qeveria shqiptare për të mundësuar procesin e rindërtimit nga pasojat e tërmetit të vitit 2019 në një kohë sa më të shpejtë, administrata tatimore zbatoi një projekt të menaxhimit të riskut për subjektet e përfshira në procesin e rindërtimit dhe që janë pajisur me Autorizimin "Për përjashtim nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit". Në kuadër të zbatimit të këtij plani sektorial, qëllimi i administratës është ndërgjegjësimi i tatimpaguesve, për: 1. Deklarim real dhe në kohë të detyrimeve tatimore. 2. Mosabuzim me autorizimin e marrë dhe mënyrën e zbatimit të përjashtimit nga TVSH-ja për aktivitetet e rindërtimit.

Forma e trajtimit të tyre konsiston në dërgimin e letrave të personalizuara ata tatimpagues që nuk kanë rezultuar me rregulla të thyera nga pikëpamja tatimore bazuar në analizën e riskut. Ndërsa për ata tatimpagues të cilët kanë rezultuar mospërmbushës janë planifikuar 125 vizita fiskale, 45 kontrolle tatimore në ambientet e TP-së, si dhe 324 kontrolle nga zyra për TP-në që nuk janë të pajisur me autorizimin "Për përjashtim nga TVSH për subjektet e rindërtimit", por kanë bërë shitje pa TVSH ndaj tatimpaguesve të pajisur me autorizimin, për sa i përket detyrimit për rregullim të TVSH-së. Janë realizuar 45% e kontrolleve nga zyra dhe kemi të dhëna në shifra për efektin në detyrim pagese për TVSH-në, që aktualisht rezulton në vlerën 53.735.561 lekë.

Ky proces është në vijimësi dhe gjatë vitit 2022 do të pasqyrojmë një përmbledhje të gjetjeve nga vizitat fiskale dhe kontrollet në ambientet e tatimpaguesve për të konkluduar mbi këtë plan sektorial.

Pandemia e COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në ekonominë shqiptare gjatë vitit të kaluar. Përgjatë vitit 2020 ekonomia globale u përball me vazhdimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria

vendosi kufizime të lëvizjes së lirë që prej muajit mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe, për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT-i, PBB-ja reale u tkurr me 2.34 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë, duke u pasuar nga një rënie më e thellë prej -10.20 përqindësh në tremujorin e dytë dhe nga statistikat e fundit të publikuara nga INSTAT-i, në tremujorin e tretë, rënia është zbutur në shifrën -3.47 për qind krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2019. Ndërsa në terma nëntëmujorë për vitin 2020, ekonomia ka pësuar rënie me 5.52 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të 2019.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, sipas vlerësimeve të INSTAT-it, gjatë nëntëmujorit të vitit 2020 janë tkurrur në mënyrë drastike me rreth 29.6 për qind. Por, ndërkohë, duke qenë se edhe tkurrja e importeve të mallrave dhe të shërbimeve ka qenë po ashtu tepër e fortë, si dhe në reflektim të peshës së lartë që importet kanë në ekonominë tonë, ka rezultuar në një rritje të kërkesës së huaj neto (ngushtim të deficitit midis eksporteve dhe importeve) krahasuar me një vit më parë me rreth 6.6 për qind, e rrjedhimisht duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej rreth 1.2 pikë përqindjeje.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, dy sektorët të cilët kanë pësuar rritje përgjatë periudhës nëntëmujore të viti 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: "Bujqësia" me rritje prej 1.8 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.3 pikë përqindjeje, si dhe "Aktivitete të pasurive të paluajtshme" me rritje prej 5.9 përqindësh dhe kontribut pozitiv prej 0.4 pikë përqindjeje. Sektorët e tjerë kanë pësuar rënie në rendin vijues, ku: "Tregtia me shumicë dhe pakicë" është ulur me 15 për qind, dhe kontribut negativ prej 2.4 pikë përqindjeje; "Aktivitete shkencore dhe profesionale" me rënie prej 14.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.9; "Arte, argëtim dhe çlodhje", me rënie prej 10.8 përqindësh dhe kontribut prej -0.2; "Industria" me rënie prej 5.4 përqindësh dhe kontribut prej -0.7 pikë përqindjeje etj.

Dinamika në tregun e punës ka reflektuar përgjithësisht atë të aktivitetit ekonomik. Ndërkohë që viti 2019 rezultoi me një reduktim të mëtejshëm të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për gjithë vitin prej 12 përqindësh (për grup-moshën 15–64 vjeç), nëntëmujori i 2020 regjistroi një përkeqësim të konsiderueshëm të këtij treguesi në gjysmën e parë të vitit dhe më pas një rikuperim në tremujorin e tretë. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) regjistroi nivelin prej 11.9 përqindësh në tremujorin e parë, 12.5 për qind në të dytin dhe ra sërish në 12.1 për qind në T3-2020. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2020-ës ishte 12.2 për qind, duke qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel prej 12.1 përqindësh të nëntëmujorit të 2019. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 regjistroi nivelin prej 11.6 përqindësh, me një rritje prej vetëm 0.2 pikë përqindjeje nga tremujori i tretë i 2019.

Shumë nga sfidat strukturore të përshkruara më sipër kanë luajtur një rol ose në përforcimin e ndikimit në epidemisë e COVID-19 ose në kufizimin e fushëveprimit të përgjigjeve të politikave për të zvogëluar ndikimin e saj. Në qershor 2021, Këshilli Shqiptar i Investimeve nisi rezultatet e sondazhit me temë "Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në aktivitetin e biznesit në Shqipëri". Ky anketë bazohet në sondazhin e parë të kryer nga Sekretariati gjatë muajit prill 2020 dhe synon të mbledhë të dhëna për periudhën 12-mujore (prill 2020–prill 2021). Sondazhi "Vlerësimi i ndikimit të pandemisë COVID-19 në biznesin në Shqipëri", një iniciativë e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, u ndërmor në periudhën prill–maj 2020, me qëllim mbledhjen e provave mbi efektet e pandemisë COVID-19 në biznesin dhe aktivitetin e saj.

Sipas sondazhit:

- Kompanitë kanë vazhduar të përdorin shërbimet *online*, kryesisht shërbimet qeveritare dhe në një masë më të vogël shërbimet *online* të institucioneve financiare.

- Kompanitë që kanë deklaruar se kanë përdorur shërbimet *online*, në 86% e tyre deklarojnë se do të vazhdojnë t'i përdorin ato në të ardhmen.

- 86% e kompanive të intervistuara në fillim të pandemisë deklaruan se nuk kishin një strategji emergjence. Sot, një vit më vonë, 52% e kompanive deklarojnë se do të miratojnë një plan emergjence, më të predispozuar janë bujqësia, tregtia dhe turizmi.

- 60% e kompanive mbi 14 milionë lekë vlerësojnë se do të miratojnë plane emergjente, ndërkohë që vetëm 47% e kompanive deri në 5 milionë lekë e konfirmojnë këtë.

- Pandemia duket se ka përshpejtuar nevojën që kompanitë të fokusohen tek inovacioni, 57% e të anketuarve thonë se kanë ndryshuar planet e tyre të investimeve drejt inovacionit, kryesisht teknologjive të reja dhe menaxhimit të rrezikut. Bujqësia është sektori me dëshirën më të lartë për t'u orientuar drejt inovacionit.

- Bujqësia do të investojë më shumë në forcimin e kanaleve tregtare, menaxhimin e rrezikut dhe teknologjitë e reja. Turizmi në menaxhimin e riskut dhe formimin profesional.

- Pavarësisht përmasave, kompanitë deklaruese kanë ndryshuar planet e tyre të investimit drejt Inovacionit, kryesisht menaxhimit të riskut dhe formimit profesional.

b) Masat e reformës

Masa e reformës 06: Fuqizimi i luftës kundër informalitetit

1. Përshkrimi i masës

Nismat kryesore të marra nga administrata e taksave kundër informalitetit në vitin 2021 u bazuan në parime dhe objektiva të qartë bazuar në inteligjencën (risk).

Faza e parë e zbatimit të fiskalizimit, e cila konsiston në transaksione pa para të gatshme ndërmjet tatimpaguesve dhe subjekteve publike (B2G) ka nisur më 1 janar 2021; Faza e dytë e transaksioneve pa para ndërmjet tatimpaguesve (B2B) ka filluar më 1 korrik 2021, ndërsa më 1 shtator 2021 ka nisur faza e fundit për transaksionet me *cash* tatimpagues-konsumator (B2C). Të dhënat në dispozicion janë si vijon:

- Rreth 59.000 tatimpagues aktivë të fiskalizuar dhe mbi 126 milionë fatura të fiskalizuara që prej datës 1 janar 2021;

- 88.609 tatimpagues ose 73% e totalit të tatimpaguesve aktivë janë pajisur me certifikatë fiskalizimi;

- 21.878 tatimpagues ose 86.4 % e tatimpaguesve aktivë Biznes i Madh (BM) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 18.643 tatimpagues aktivë BM ose 73.6 % e totalit të BM kanë lëshuar fatura të fiskalizuara;

- 64.698 tatimpagues ose 71.1% e tatimpaguesve aktivë Biznes i Vogël (BV) janë pajisur me certifikatë fiskalizimi. 37.654 ose 41.4% e tatimpaguesve aktivë BV kanë lëshuar fatura të fiskalizuara.

Në kuadrin e luftës kundër informalitetit, administrata tatimore hartoi dhe zbatoi veprimet e mëposhtme:

1. Plani Sektorial i Turizmit 2021;
2. Rregullat e riskut për mbikëqyrjen e tatimpaguesve në kuadrin e ndryshimit të pragut të TVSH-së;
3. Plani Sektorial i Rindërtimit.

Rezultatet kryesore nga këto iniciativa janë:

1. Plani Sektorial i Turizmit 2021

- Rritje me 8% e xhiros gjatë sezonit turistik 2021, krahasuar me vitin 2019 për të njëjtën periudhë për tatimpaguesit aktivë të synuar;

- 4% rritje e pagesës së TVSH-së duke identifikuar dhe inkurajuar tatimpaguesit që rezultojnë në mosdeklarim apo pagesë të vonuar;

- Reduktim me 25% të numrit të tatimpaguesve (TP) që deklarojnë në listë pagesë vetëm 1 punonjës;

- Zvogëlim me 15% të numrit të punonjësve me pagë minimale ose më pak.

2. Plani Sektorial i Rindërtimit

U identifikuan tatimpagues me risk:

- shitjet e mëdha të përjashtuara nga TVSH-ja;
- tatimpagues me përqindjen më të lartë të punonjësve nen pagën minimale;
- tatimpagues me një rënie në koeficientin e pagesës së TVSH-së;
- tatimpagues që rezultojnë me 1–3 punonjës;
- tatimpagues që në mars 2020 rezultuan në një rënie në numrin e punonjësve;
- tatimpagues që rezultuan me humbje gjatë vitit 2020.

Bazuar në këto kritere risku, forma e trajtimit të riskut për tatimpaguesit e identifikuar ishte: kontrolli i plotë tatimor, kontroll nga zyra, vizitat fiskale, monitorimi, kontakti me letra dhe telefonata.

Gjatë periudhës në vijim, vëmendja e administratës tatimore do të përqendrohet në vazhdimin e trajtimit të informalitetit në tregun e punës dhe në hartimin e planeve sektoriale për sektorin e energjisë elektrike dhe

hidrokarbureve, si dhe trajtimin e çdo sjelljeje mospërmbushëse të identifikuar për sektorë të ndryshëm, lloje të ndryshme tatimesh, vendndodhje gjeografike apo madhësi të ndryshme tatimpaguesish.

Reforma e parashikuar për zbatim gjatë periudhës 2022–2024 do të kontribuojë në reduktimin e mëtejshëm të informalitetit dhe mundësimin e shërbimeve më cilësore në sektorin e taksave.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022–2024

a) Automatizimi i procedurave të rimbursimit të TVSH-së, duke rezultuar në zerimin e detyrimeve të prapambetura të rimbursimit TVSH në vitin 2022.

b) Kriteret e reja dhe të përmirësuara të riskut për identifikimin e tatimpaguesve në mospërmbushje të detyrimeve tatimore (tatimpaguesit me rritje të të ardhurave, por ulje të detyrimit TVSH; tatimpaguesit që nuk deklarojnë shpenzimet për faturat e energjisë elektrike; tatimpaguesit me paga të nëndeklaruara për punonjësit e tyre – të identifikuara duke krahasuar të dhënat disavjeçare).

c) Trajtimi i evazionit fiskal, mashtrimit fiskal dhe informalitetit, duke përdorur në kohë reale mbikëqyrjen e transaksioneve financiare midis tatimpaguesve, sipas sistemit të sapozbatuar të fiskalizimit (sistemi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive tregtare të tatimpaguesve nga autoritetet tatimore shqiptare). Ky sistem do të sjellë më shumë raportime transaksionesh me para në dorë dhe do të reduktojë transaksionet e fshehura pa para, me kontroll më të mirë të sistemit fiskal. Do të ndihmojë, gjithashtu, efikasitetin në raportimin fiskal, duke mbledhur më shumë të dhëna nga tatimpaguesit dhe duke parambushur deklaratën e TVSH-së me këto të dhëna.

d) Detektimi i të ardhurave globale të padeklaruara nga tatimpaguesit dhe individët, nëpërmjet shkëmbimit të parë automatik të informacionit mbi llogaritë financiare në vitin 2021 e në vijim, sipas Standardit të Përbashkët të Raportimit të OECD-së.

e) Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta në *Data Warehouse* të administratës tatimore, {autoritetet kombëtare të shërbimeve (uji, elektriciteti), regjistrimi i automjeteve, bashkitë etj.} Duke marrë në konsideratë hendekun e TVSH-së, si dhe mospërputhjet e të dhënave, mbledhjen e të dhënave dhe administrimin e mirë të tyre, ndërtimi i një *Data Warehouse* (si një nga rekomandimet e FMN-së) me të dhëna të centralizuara, të menaxhuara nga vetëm një burim, bëhet një hap i madh përpara në lidhje me luftën kundër informalitetit.

f) Ndërtimi i Regjistrit të Aseteve të Tatimpaguesve (te tundshme dhe patundshme), me qëllim vlerësimin real të pasurive të tatimpaguesve, duke ndërtuar një sistem për verifikimin dhe ndjekjen e të ardhurave të tatimpaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të bëra mbi taksat e pasurisë. Ky proces do të kalojë nëpër 3 faza: a) krijimi i një regjistri asetesh me atributet përkatëse; b) shkëmbimi i të dhënave me *web-service*; c) analiza e të dhënave me raportet *BI*.

g) Hartimi dhe zbatimi i një program përmbushjeje për individët më të pasur.

h) Fuqizimi i sistemit dhe përdorimi i të dhënave në procesin e vendim-marrjes në lidhje me individët e pasur.

i) Përdorimi i qasjes së integruar për zbatimin e strategjisë se përmbushjes se individëve të pasur.

j) Zbatimi i planit sektorial të turizmit.

k) Analiza dhe zbatimi i rregullave të riskut për monitorimin e tatimpaguesve në kuadrin e ndryshimit të pragut të TVSH-së në 10 milionë lekë.

l) Zbatimi i planit sektorial të informalitetit në tregun e punës në 4 komponentët e tij.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë (2022)	I ndërmjetëm (2023)	Synimi (2024)
Krijimi i listës me individët më të pasur bazuar të informacioni brenda dhe jashtë sistemit tatimor	100 individë	200 individë	350 individë
Niveli i realizimit: Matja e hendekut tatimor për individët më të pasur, hartëzimi i risqeve dhe përcaktimi i strategjive trajtuese	80%	90%	100%

Tregues	Bazë (2022)	I ndërmjetëm (2023)	Synimi (2024)
Rritja (me 4% çdo vit) e TVSH-së së pagueshme në sektorin e turizmit	570.020 mln Lek	4%	4%

Reduktimi i punës së padeklaruar dhe rritja (me 1% çdo vit) e punonjësve të deklaruar	701.739 punonjës	1%	1%
Ulja (me 3% çdo vit) e numrit të pagave të nëndeklaruara (ne nivelin minimal ose me pak (338.877 paga të tilla në vitin 2021)	338.877 paga	3%	3%

Tregues	Bazë (2021)	I ndërmjetëm (2022)	Synimi (2023)
Niveli i realizimit: - Ndërtimi i *Data Warehouse* dhe popullimi i tij me të dhëna të brendshme dhe nga palë të treta	50%	80%	100%
Niveli i realizimit – Ndërtimi i Regjistrit të Aseteve të Tatimpaguesve	20%	50%	100%

3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Forcimi i luftës kundër informalitetit në ekonomi do të krijojë një klimë më të mirë të taksimit të drejtë dhe do të rrisë besimin e taksapaguesve ndaj administratës tatimore. Gjithashtu, do të reduktojë konkurrencën e pandershme ndërmjet bizneseve formale dhe atyre informale, do të rrisë të ardhurat dhe, në mënyrë indirekte, fondet e disponueshme për investime në infrastrukturë.

4. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit

Buxheti i shtetit.

5. Ndikimi i pritshëm në përfundimet sociale si punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore dhe aksesi në kujdesin shëndetësor

Kjo masë reforme kontribuon në konkurrencën dhe do të lejojë, gjithashtu, pakësimin e kostos së mbledhjes së të ardhurave. Duke rritur numrin e punonjësve të deklaruar dhe numrin e pagave të deklaruara në nivelin real të tyre, kjo do të kontribuojë indirekt në krijimin e vendeve të punës, taksimin e drejtë dhe sigurimin më të mirë shoqëror për punonjësit. Kjo masë reforme mund të ndikojë pozitivisht në barazinë gjinore, do të rrisë punësimin formal, do të rrisë të ardhurat dhe rrjedhimisht edhe fondet e disponueshme për investime në infrastrukturë dhe për mbulim shëndetësor.

6. Ndikimi i pritshëm në mjedis dhe ndryshimi i klimës

Nuk ka impakt të pritshëm në mjedis apo në ndryshime klimatike nga masa e propozuar e reformës.

7. Rreziqet e mundshme

Rreziku	Mundësia (e ulët, e lartë)	Veprimi zbutës i parashikuar
Vonesa në aktivitete	I ulët	Monitorim i rregullt i zbatimit të aktiviteteve

Masa e reformës 07: Zhvillimi i kuadrit ligjor për të mbështetur start-up inovative

1. Përshkrimi i masës

Vitet e fundit, roli i *start-up*-eve ka fituar vazhdimisht rëndësi si një forcë lëvizëse për zhvillimin ekonomik dhe social drejt një shoqërie të bazuar në dije. Suksesi i kompanive fillestare dhe potenciali i tyre për t'u rritur varet nga një sërë faktorësh.

Ekosistemi shqiptar është mbështetur nga projekti i BE-së "BE për inovacionin". Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i ekosistemit të *start-up*-eve dhe promovimi i *start-up*-eve në Shqipëri. Ky projekt financohet nga IPA II 2014–2020 për sektorin e konkurrueshmërisë dhe inovacionit, në vlerë prej 6,600,000 eurosh, dhe me mbështetjen e qeverisë gjermane, në vlerë prej 719,238 eurosh dhe qeverisë Suedeze, në vlerë prej 220,000 eurosh. Buxheti i përgjithshëm i këtij projekti është 7.539.238 euro. Projekti përfundon në mars 2022. Komponenti i grantit "Fondi i sfidës" ishte 2.2 milionë euro nga BE-ja dhe 220.000 euro nga qeveria suedeze. Përfitues kanë qenë 33 *start-up* inovative për të cilat është dhënë kontrata dhe ISO (organizatat mbështetëse të inovacionit).

Një draft për një ligj të ri *start-up* u miratua nga një grup pune ndërministror pranë ministrit të Shtetit për sipërmarrjen. Projektligji "Për mbështetjen dhe zhvillimin e bizneseve fillestare", i është paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave. Ai synohet të miratohet brenda vitit 2021.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri të favorshëm rregullator dhe institucional për krijimin dhe zhvillimin e *start-up*-eve, për të nxitur kërkimin, zbatimin dhe përdorimin e ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat nxisin ekonominë dhe përçarjen e tyre. vjen me të. Ky projektligj do të

përcaktojë masat mbështetëse, organet shtetërore, kriteret, rregullat dhe procedurat që zbatohen për vetë deklarimin dhe mbështetjen *online* të *start-up*-ve dhe krijimin e një ekosistemi të favorshëm për to në Republikën e Shqipërisë.

Ligji ka paraparë masa mbështetëse për *start-up*-et dhe themelimin e Këshillit të sipërmarrjeve fillestare.

Në VKM-në nr. 466/2021, "Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve dhe plani i veprimit 2021–2027", fusha e ndërhyrjes "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni" njeh kontributin e rëndësishëm që SME-të dhe bizneset e reja mund të japin për një më shumë inovacion dhe njohuri. ekonomia e drejtuar. Ai pranon, gjithashtu, se ekosistemi i sipërmarrjes dhe i inovacionit është ende në një fazë fillestare dhe "masa kritike", që lejon organizatat mbështetëse të bëhen të vetë qëndrueshme nuk është arritur ende.

Qëllimi dhe objektivat e politikës marrin parasysh se kushtet aktuale janë sfiduese për NVM-të dhe bizneset fillestare. Ndër të tjera, kjo lidhet me aksesin në financa dhe tregje, ndikimin e pandemisë COVID-19 dhe sfidat në kontekstin e tranzicionit të gjelbër dhe digjital.

Ekziston nevoja për të përmirësuar skemat ekzistuese të granteve për NVM-të dhe për të hartuar mjete dhe instrumente të reja financiare për të përmirësuar aksesin në financa. Për më tepër, ekziston nevoja për të rritur dinamikën e inovacionit dhe bizneseve fillestare dhe për të nxitur specializimin për të arritur këtë "masë kritike" duke u fokusuar në zinxhirët më premtues të vlerës. Në këtë sfond, për këtë fushë ndërhyrjeje parashikohet një qasje e integruar dhe e synuar që promovon specializimin e zgjuar. Forcimi i lidhjeve ndërmjet të gjithë aktorëve dhe komponentëve të ekosistemit konsiderohet si një faktor suksesi ndërsektorial.

a) Aktivitete të planifikuara më 2022-shin

a) Miratimi i projektligjit të ri për bizneset fillestare:

b) Hartimi i akteve nënligjore të ligjit të miratuar për bizneset fillestare:

c) Krijimi i Këshillit të *start-up*-ve:

d) Krijimi i portalit *online* për vetë regjistrimin *online* të bizneseve fillestare dhe lehtësuesve.

b) Aktivitete të planifikuara më 2023-shin

a) Plotësisht funksional krijimi i Këshillit të *start-up*-ve:

b) Zbatimi i ligjit për *start-up*, me fokus në masat mbështetëse:

c) Drejtimi i portalit *online* për vetë regjistrimin *online* të bizneseve fillestare dhe lehtësuesve.

c) Aktivitete të planifikuara më 2024-ën

a) Drejtimi i Këshillit të *start-up*-ve:

b) Zbatimi i ligjit për *start-up*, me fokus në dhënien e masave mbështetëse për *start-up*-et e vetëdeklaruara *online*:

c) Drejtimi dhe mirëmbajtja e portalit *online* për vetë regjistrimin *online* të bizneseve fillestare dhe lehtësuesve.

2. Treguesit e rezultateve

Tregues	Bazë	I ndërmjetëm (2022)	Synimi (2024)
Miratimi i ligjit të ri "Për *start-up*-et" dhe akteve nënligjore	Në ripunim	Zbatim	Zbatim
Krijimi i Këshillit të *start-up*-ve	Në ripunim	Zbatim	Zbatim
Miratimi i kuadrit të politikave dhe skemave mbështetëse për bizneset fillestare	0	Zbatim	Zbatim
Të paktën dy thirrje për aplikime për skemat mbështetëse për *start-up*-et dhe të paktën 10 fillime të financuara nga thirrjet	23 *start-up*-et dhe 4 grante të organizatave mbështetëse të inovacionit, në kuadër të thirrjeve të para dhe të dyta të nisura gjatë vitit 2019. Thirrja e tretë ka nisur në vitin 2020 dhe aktualisht është në fazën përfundimtare të vlerësimit.		

3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri

Politikat e sipërmarrjes dhe fillimit mund të inkurajojnë shfaqjen dhe rritjen e kompanive fillestare, duke ofruar një mjedis miqësor ndaj sipërmarrjes (p.sh. përmes lehtësimit të barrës financiare për bizneset

Masa e reformës: Forcimi dhe zgjerimi i mbulimit të mbrojtjes sociale duke reduktuar pabarazinë dhe duke mbështetur rritjen gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme:		**Faza e zbatimit të reformës (0–5)**
Aktivitete të planifikuara për vitin 2021	Vlerësimi i përshtatshmërisë së përfitimeve të ndihmës ekonomike duke marrë në konsideratë të dhënat nga Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës dhe vendosja e një mekanizmi transparent për rishikimin e tyre të rregullt vjetor.	
	Zbatimi i sistemit të vlerësimit biopsikosocial për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara me para dhe kujdes social në tri qarqe (Tiranë, Durrës dhe Elbasan).	
	Mbështetje për personat nga shtresat e pafavorizuara, veçanërisht përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara drejt punësimit në ndërmarrjet sociale. Financimi i ndërmarrjeve sociale	
	Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore për të gjitha kategoritë në nevojë në kuadër të fondit social	
	Vlerësimi i të gjitha institucioneve publike të kujdesit rezidencial dhe zhvillimi i planit të transformimit të tyre.	
	Hartimi i planeve kombëtare të veprimit për përfshirjen sociale dhe reduktimin e varfërisë përmes politikëbërjes dhe treguesve të përmirësuar.	
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse është i pjesshëm ose aspak.	MSHMS-ja ka ngritur një grup pune ndërinstitucional me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Statistikave. Ky grup pune u krijua në bazë të urdhrit nr. 269, datë 28.5.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka përgatitur draft dokumentin për rishikimin e masës së përfitimit dhe një udhërrëfyes për shqyrtimin e rregullt të tyre.	3
	Sistemi i vlerësimit biopsikosocial për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara me mbështetje të kombinuar në para dhe kujdes social po zbatohet në tri qarqe Tiranë, Durrës dhe Elbasan.	5
	Aktualisht, 8 OJF kanë marrë statusin e ndërmarrjeve sociale.	3
	Financimi i 12 shërbimeve të specializuara ka vijuar në nivel qarku dhe për herë të parë në vitin 2021 financohet shërbimi i ndihmës për familjen në qarkun e Tiranës.	4
	Grupi teknik i ngritur, me urdhrin e ministrit nr. 548/2020, "Për ngritjen e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit", ka hartuar dhe miratuar tashmë metodologjinë e vlerësimit të burimeve njerëzore dhe financiare aktuale për funksionimin e 9 Institucioneve Publike të Kujdesit Social ekzistues. Procesi fillestar i vlerësimit, ende nuk ka filluar si pasojë e pandemisë COVID-19.	3
	Gjatë këtij viti janë miratuar: ✓- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2021–2026.	5

	✓- Plani i Veprimit për Personat LGBTI+, 2021–2027. ✓- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025". ✓- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030	

Masa e reformës: Përmirësimi i punësueshmërisë së punëkërkuesve të papunë më vulnerabël, veçanërisht atyre të prekur nga COVID-19, përmes PNP-ve dhe shërbimeve të punësimit të reja dhe të rishikuara		**Faza e zbatimit të reformës (0–5)**
Aktivitetet e planifikuara për vitin 2021	Vazhdimi i operacionalizimit të funksioneve të AKPA-s dhe mbështetjes së kapaciteteve për stafin e AKPA-s në të gjitha nivelet.	4
	Finalizimi i sistemit të informacionit të NAES	3
	Profilizimi i punëkërkuesve dhe zhvillimi i planeve individuale të punësimit.	5
	Zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit të fokusuar në programet e dedikuara për COVID-19, që synojnë mbështetjen dhe aktivizimin e grupeve më vulnerabël dhe numri i punëkërkuesve të regjistruar të papunë që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit synohet të arrijë në 6.7%.	4
	Hartimi i programit të garancisë për të rinjtë (VKM), që synon papunësinë e të rinjve veçanërisht NEET.	2
	Zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara me komunat në zonat e pambuluara.	5
	Ndërmarrja e një analize të nevojave për aftësi.	2
	Maksimizimi i ndërveprimit dhe përmirësimi i synimit të politikave aktive të tregut të punës dhe zbatimi i paketës së përgatitur të reformës së Arsimit dhe Formimit Profesional, duke përfshirë aftësimin dhe rikualifikimin, përmes një sistemi referimi për ndjekjen e punëkërkuesve që marrin shërbime të formimit profesional, ndërmjetësim në punë ose programe të nxitjes së punësimit, brenda Kurse "Start Smart" dhe/ose kurse formimi profesional.	4
	Kryeni një vlerësim të procesit mbi zbatimin e Paketave të Reformuara të Nxitjes së Punësimit (PNP) dhe programeve që trajtojnë kontekstin pas COVID-19.	3

SHTOJCA II

Masat e reformës in ERP 2021–2023	Sfidat kyçe strukturore (vlerësimi i KE-së për ERP 2020–2022)	Rekomandimet 2021 të ERP	Paketa e zgjerimit 2021	Objektivat e Qëndrueshëm të Zhvillimit 2020–2030	Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor	Agjenda digjitale evropiane/Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor	Projekte IPA III që mbështetin reformën
Liberalizimi i mëtejshëm i tregut të energjisë	Sfida kyçe #2	N/A		SDG #7	Të dyja masat e kësaj reforme janë në përputhje me Parimet e Marrëveshjes së Madhe të BE-së për sigurimin e një furnizimi të sigurt dhe të përballueshëm me energji në një treg funksional digjital të energjisë (ALPEX) dhe nëpërmjet përmirësimeve të performancës së energjisë në ndërtesa dhe industri, siç përshkruhet në masën e mësipërme me secilin aktivitetit. Objektivat në BE *GreanDeal* janë në përputhje me objektivat kombëtarë në Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe në draftin NCEP në fazën e miratimit.	Aplikimi i TIK-ut në disa fusha në mënyrë të ndjeshme që ndikon në mënyrën se si do të ndërtohet në të ardhmen janë pjesë e masave. Këtu mund të përmendet Digital ALPEX që do të kryejë *online* si shkëmbim energjie në kohë reale; Projektet e qytetit të zgjuar në zhvillim nga AEE; Rrjeti i Energjisë; Pajisjet inteligjente mund t'i ndërgjegjësojnë konsumatorët për energjinë e përdorur dhe t'i ndihmojnë ata të reduktojnë konsumin e tyre të energjisë në kohë reale, të ndryshojnë sjelljen e tyre ndaj përdorimit të energjisë dhe të kursejnë para në faturat e tyre të energjisë etj.	N/A

Diversifikimi i burimeve të energjisë përmes promovimit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe përmirësimeve të eficiencës së energjisë	Sfida kyçe #2			SDG #7	Të dyja masat e kësaj reforme janë në përputhje me Parimet e Marrëveshjes së Madhe të BE-së për sigurimin e një furnizimi të sigurt dhe të përballueshëm me energji në një treg funksional digjital të energjisë (ALPEX) dhe nëpërmjet përmirësimeve të performancës së energjisë në ndërtesa dhe industri, siç përshkruhet në masën e mësipërme me secilin aktivitetit. Objektivat në BE *GreanDeal* janë në përputhje me objektivat kombëtarë në Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe në draftin NCEP në fazën e miratimit.	Aplikimi i TIK-ut në disa fusha në mënyrë të ndjeshme që ndikon në mënyrën se si do të ndërtohet në të ardhmen janë pjesë e masave. Këtu mund të përmendet Digital ALPEX që do të kryejë *online* si shkëmbim energjie në kohë reale; Projektet e qytetit të zgjuar në zhvillim nga AEE; Rrjeti i Energjisë; Pajisjet inteligjente mund t'i ndërgjegjësojnë konsumatorët për energjinë e përdorur dhe t'i ndihmojnë ata të reduktojnë konsumin e tyre të energjisë në kohë reale, të ndryshojnë sjelljen e tyre ndaj përdorimit të energjisë dhe të kursejnë para në faturat e tyre të energjisë etj.	1. GATE project completes the implementation of the project May 2022; The Reehub + project completes the project within 2022;
Rehabilitimi dhe ndërtimi i segmentit hekurudhor Durrës-TIA-Tiranë							
Reforma në Sektorin e Ujit dhe Ujërave të Zeza							

Qeverisje dhe shërbime më të mira detare dhe detare							
Forcimi i luftës kundër informalitetit		PG 4					
Zhvillimi i një kuadri ligjor në mbështetje të *start-up*-eve inovative	Sfida Kyçe #3	PG 5					
Përmirësimi i aksesit në financa për NVM-të	Sfida Kyçe #3						
Modernizimi i instrumenteve të pagesave me pakicë	Sfida Kyçe #3	n/a	Nuk ka një rekomandim specifik në paketën e zgjerimit. Reforma, megjithatë, synon të përmbushë objektivat e strategjisë kombëtare të Shqipërisë për pagesat e vogla (NRPS) për 2018–2023, përmes miratimit të ligjit mbi shërbimin e pagesave dhe ligjit për llogaritë e pagesave, që synojnë harmonizimin me direktivat përkatëse të BE-së, nën kapitullin 4 të *Acquis*.	n/a	n/a	n/a	n/a
Përmirësimi i kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore për kërkimin dhe inovacionin	Sfida Kyçe #1				S'ka rekomandime		E vetmja asistencë e planifikuar që i përgjigjet kësaj fushe është binjakëzimi në lidhje me përmirësimin e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të

							Kërkimit Shkencor dhe inovacionit në lidhje me përafrimin e legjislacionit në fushën e kërkimit shkencor me legjislacionin përkatës të BE-së. Ky projekt ende nuk ka filluar të zbatohet.
Zhvillimi i infrastrukturës *broadband* për ekonominë digjitale							
Lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të mallrave							
Finalizimi dhe mbështetja e zbatimit të reformës kurrikulare parauniversitare, trajnimit dhe punësimit të mësuesve	Sfida kyçe #3		S'ka rekomandime	SDG4	S'ka rekomandime	Masa e re reformuese e propozuar për 2022-2024 Masa e reformës 19: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale	Nuk ka projekte të miratuara apo projekte të planifikuara sipas IPA III që mbështesin këtë masë.
Gjithëpërfshirje dhe barazi në arsim	Sfida Kyçe #3		S'ka rekomandime	SDG4	S'ka rekomandime	Masa e re reformuese e propozuar për 2022-2024 Masa e reformës 19: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale "Rritja e shkrim-leximit, aftësive dhe përfshirjes digjitale; Epoka digjitale duhet të fuqizojë dhe emancipojë, mjedisi ose aftësitë nuk duhet të jenë pengesë për të arritur këtë	Nuk ka projekte të miratuara apo projekte të planifikuara sipas IPA III që mbështesin këtë masë. Sipas IPA II, reforma mbështetet nga "BE për përfshirjen sociale dhe ndërhyrjen". Kjo ndërhyrje përfshin MSHMS, MFE dhe MAS. Për sa u përket fushave të kompetencës së MAS-it, ky projekt mbështet përfshirjen në

						potencial.	kurrikulat e barazisë në praktikat arsimore, caktimin e shërbimeve psikosociale në nivel shkolle me materiale përkatëse.
Përmirësimi i cilësisë dhe mbulimit të AFP-së duke siguruar lidhje me tregun e punës	Sfida Kyçe #1						
Përmirësimi i punësueshmërisë së punëkërkuesve të papunë më vulnerabël nëpërmjet PNP-ve dhe shërbimeve të punësimit të synuara më mirë	Sfida Kyçe #1	PG 6		SDG 8	E patargetuar	Objektiv i rëndësishëm	
Forcimi dhe zgjerimi i mbulimit të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale duke reduktuar pabarazinë dhe duke mbështetur rritjen gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme		PG 6					
Rritja e aksesit në kujdesin shëndetësor		PG 6					

SHTOJCA III
KONTRIBUTET E JASHTME
NË E ERP 2022–2024

Draft-ERP 2022–2024 u publikua në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsultim të gjerë nga grupet e ndryshme të interesit, nga data 22 dhjetor 2021 deri më 31 janar 2022, në linkun: https://www.financa.gov.al/programi-i-reformave-ekonomike/. Gjatë kësaj periudhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka mirëpritur dërgimin e komenteve, reagimeve apo sugjerimeve nga grupet e interesit. Deri në momentin e dorëzimit të dokumentit të ERP 2022–2024 te Komisioni Evropian, nuk është dërguar asnjë koment. Gjithashtu, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", projektvendimi për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022–2024 u shpall në regjistrin e njoftimeve dhe të konsultimeve publike.

VENDIM
Nr. 65, datë 2.2.2022

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2022 NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2022 është gjithsej 850 (tetëqind e pesëdhjetë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues	53;
b) Për kategorinë e mesme drejtuese	3;
c) Për kategorinë e ulët drejtuese	190;
ç) Për kategorinë ekzekutive	604.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakte;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i lartë ushtarak/policor;
- Arsim i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2022, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2022

1. Kryeministria dhe institucionet në varësi të saj;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i ministrisë së Brendshme;
4. Sistemi i ministrisë së Mbrojtjes;

5. Sistemi i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
12. Ministria e Kulturës.

VENDIM
Nr. 67, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR MARRJEN E LEJEQËNDRIMIT TË PËRKOHSHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR MARRJEN E LEJEQËNDRIMIT TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim "Palët nënshkruese",

duke vlerësuar marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

duke marrë parasysh vullnetin për të forcuar dhe për të zhvilluar më tej bashkëpunimin dypalësh;

duke përfituar nga afërsia gjeografike, kulturore, historike dhe sociale;

duke marrë në konsideratë vullnetin e përbashkët për sigurimin e një perspektive më të mirë për shtetasit e dy vendeve;

me qëllim për të thjeshtësuar procedurat dhe masat administrative të lidhura me leje qëndrimet e përkohshme,

bien dakord si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është lehtësimi i procedurave dhe kritereve për pajisjen me leje qëndrimit të përkohshme për shtetasit e të dyja palëve nënshkruese.

Leje qëndrimi e përkohshme, sipas kësaj marrëveshje nënkupton pajisen me leje qëndrimi të përkohshme për shtetasit e palëve nënshkruese me afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet, në bazë të përmbushjes së kritereve të përgjithshme referuar legjislacionit kombëtar të Palëve nënshkruese.

Neni 2

Për pajisjen me leje qëndrimi të përkohshme shtetasit e palëve nënshkruese duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

a) dokument udhëtimi i vlefshëm;

b) adresa e saktë e qëndrimit në territorin e palës tjetër, e vërtetuar me dokumentin përkatës (kontratë qiraje ose certifikatë e pronësisë ose deklaratë noteriale); dhe

c) Palët bien dakord, që pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të përcaktojnë me pëlqim të ndërsjellë, formularin e kërkesës për leje qëndrimi.

Neni 3

Palët nënshkruese bien dakord që shtetasit e të dyja vendeve, me hyrjen në territorin e shtetit tjetër me qëllim të qëndrimit të përkohshëm, do të lajmërojnë përmes dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, për qëndrimin e përkohshëm, me qëllim të:

a) bashkimit familjar;
b) motive studimi;
c) motive punësimi;
d) kërkime shkencore;
e) arsye të tjera të përcaktuara, sipas legjislacionit përkatës të palëve nënshkruese.

Neni 4

Shtetasit e palëve nënshkruese duhet që, me rastin e hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm në territorin e palës tjetër, të paraqiten brenda afatit të qëndrimit të ligjshëm, pranë institucioneve kompetente të palëve nënshkruese, për të aplikuar për leje qëndrimi.

Të drejtat dhe detyrimet për shtetasit e palëve nënshkruese fillojnë të rrjedhin në momentin e pranimit të aplikimit.

Neni 5

Leja e qëndrimit të përkohshëm mund të refuzohet ose anulohet/revokohet, sipas legjislacioneve kombëtare të brendshme të palëve nënshkruese.

Neni 6

Kjo Marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi menjëherë pas përfundimit të procedurave të brendshme të secilës palë për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese, përmes shkëmbimit të notave verbale.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga secila palë nënshkruese përmes rrugëve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje do të pushojë së ekzistuari 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerjen e saj.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në 3 (tri) tekste origjinale, secila në gjuhët zyrtare të palëve dhe gjuhën angleze, të gjitha tekstet njëlloj të besueshme. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e Marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Bledar Çuçi	**Xhelal Sveçla**
Ministër i Brendshëm	Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

VENDIM
Nr. 69, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR NDËRLIDHJEN E SKEMAVE PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave, për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE
PËR NDËRLIDHJEN E SKEMAVE, PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si "Palët Kontraktuese" dhe individualisht si "Pala Kontraktuese";

të bindur për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e digjitalizimit të administratës publike dhe sigurimit të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike, *e-Qeverisje*, dakordësuar nga të gjitha Palët Kontraktuese në memorandumet përkatëse të Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të administratës publike në interes të shtetasve të Palëve Kontraktuese;

duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, veçanërisht në fushën e ofrimit të shërbimeve të besuara dhe identifikimit elektronik;

duke pasur parasysh objektivat e nismës për Ballkanin e Hapur;

duke pasur parasysh Deklaratën e Përbashkët të nënshkruar në Novi Sad, më 10 tetor 2019, e cila bazohet në objektivin e zbatimit të katër lirive kryesore të tregut të përbashkët të BE-së në Ballkanin Perëndimor;

duke njohur Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Ohër, më 10 nëntor 2019;

duke pranuar Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor, në Tiranë, më 21 dhjetor 2019;

duke theksuar qëllimin, interesin dhe bazat e përbashkëta për rritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit;

duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj Marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të përmirësuar jetën e të gjithëve brenda rajonit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që Palët Kontraktuese të ofrojnë akses në shërbimet e tyre të *e-Qeverisjes*, për shtetasit e Palëve të tjera Kontraktuese, duke përdorur skemat e verifikimit për identifikimin elektronik të Palës Kontraktuese, së cilës i përket shtetasi që përdor shërbimet e qeverisjes elektronike, *e-Qeverisje*.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin:

1. Shtetas - personi që ka shtetësinë e njërës prej Palëve Kontraktuese;
2. Numri i identifikimit për Ballkanin e Hapur - tregon referencën, d.m.th. numrin unik të identifikimit, të lëshuar shtetasit nga Pala Kontraktuese, të shtetësisë së tij/saj, në përputhje me këtë Marrëveshje, me qëllim të përdorimit të shërbimeve elektronike në kuadër të iniciativës së Ballkanit të Hapur;
3. Federimi i identiteteve elektronike - vendosja e një marrëdhënie besimi ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke siguruar transmetim të sigurt të identifikimit, autentikimit dhe informacionit për identifikimin elektronik të përdoruesve që janë shtetas të njërës prej Palëve Kontraktuese, dhe që kërkojnë shërbimet elektronike të një Pale tjetër Kontraktuese; në përputhje me standardet përkatëse për federimin e identiteteve elektronike;
4. Ndërlidhja e skemave nënkupton përcaktimin e nivelit minimal të ndërveprimit të skemave *e-ID*, për autentikim elektronik ndërkufitar të shtetasve të tyre në funksion të përcaktimit të sasisë së të dhënave të shkëmbyera, formateve d.m.th., duke aktivizuar federimin e identiteteve elektronike.

Neni 3
OBJEKTI I MARRËVESHJES

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për arritjen e qëllimit të përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti ato do të:

- njohin skemat e regjistruara të identifikimit elektronik në Palët Kontraktuese të ofruara nga lëshuesit e skemave të identifikimit elektronik;

- bashkojnë/kombinojnë zgjidhjet e softeve kombëtare, që do të mundësonin federimin e identiteteve elektronike në parimin e ndërlidhjes së skemave me shërbimet e qeverisjes elektronike të Palëve të tjera Kontraktuese;

- vendosin dhe zbatojnë numrin e ID-së së Ballkanit të Hapur për shtetasit e tyre - të lëshuar nga secila Palë Kontraktuese;

- nxisin përdorimin e shërbimeve elektronike, të cilat do të konfirmonin, avanconin dhe forconin më tej objektivat në kuadër të iniciativave të bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Skemat e përmendura në këtë Marrëveshje, të ofruara nga lëshuesit e skemave të përmendura këtu dhe të regjistruara në regjistrat përkatës, do të njihen në mënyrë të ndërsjellë, regjistrat e duhur janë si më poshtë:

1. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Serbisë;
2. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të besuara dhe skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
3. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të besuara dhe i skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Shqipërisë.

Shkëmbimi i të dhënave të nevojshme për zbatimin praktik të skemave të identifikimit elektronik të njohur reciprokisht dhe të përcaktuara në këtë nen, kryhet në përputhje me standardet e ndërveprimit për shkëmbimin e të dhënave.

Neni 4
Numri i ID-së i Ballkanit të Hapur

Shtetasit mund të marrin numrin e ID-së së Ballkanit të Hapur në portalin e tyre të qeverisjes elektronike ose në portalin e tyre kombëtar për identifikim elektronik.

Një parakusht për marrjen e numrit të ID-së së Ballkanit të Hapur është që një shtetas të ketë një identitet elektronik të lëshuar sipas skemës së regjistruar të identifikimit elektronik në vendin e tij/saj.

Numri i ID-së i Ballkanit të Hapur përfaqëson një atribut shtesë të identitetit ekzistues elektronik të një shtetasi, që i jep atij/saj mundësinë për të ushtruar të drejta brenda fushës së nismës së Ballkanit të Hapur, në përputhje me marrëveshjet përkatëse dhe dokumentet e tjera që janë në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese, si dhe në përputhje me aktet normative dhe praktikën e secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 5
Koordinimi dhe komunikimi

Palët Kontraktuese duhet të krijojnë dhe mbajnë koordinimin dhe komunikimin ndërmjet autoriteteve kompetente për zbatimin teknik dhe ligjor të kësaj Marrëveshjeje.

Palët Kontraktuese duhet të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve të duhura të autoriteteve kompetente, të referuara në paragrafin e parë të këtij neni, dhe duhet të shkëmbejnë informacion për pikat e kontaktit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Përfaqësuesit e autoriteteve të referuara në paragrafin e parë të këtij neni duhet të zhvillojnë takime të rregullta, të paktën një herë në një periudhë 3 (tre)-mujore dhe duhet t'u raportojnë Palëve Kontraktuese rezultatet e këtyre takimeve. Takimi i parë do të mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Përveç komunikimit gjatë takimeve, referuar paragrafit të 3-të të këtij neni, shkëmbimi i informacionit përkatës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë në formë të shkruar, elektronike ose në letër.

Palët Kontraktuese duhet të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për çdo ndryshim, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e ndodhjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 6
Shkëmbimi dhe mbrojtja e të dhënave konfidenciale

Palët kontraktuese bien dakord që informacioni i klasifikuar, siç përcaktohet nga legjislacioni i secilës Palë Kontraktuese, nëse shkëmbehet në kuadrin e bashkëpunimit të parashikuar nga kjo Marrëveshje, do të mbahet si informacion i klasifikuar i huaj dhe se ky informacion do të ruajë nivelet e klasifikimit që i janë caktuar në Palën tjetër Kontraktuese.

Tabela e duhur e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit, e parashikuar nga legjislacioni i

brendshëm i Palëve Kontraktuese, duhet të dakordësohet dhe shkëmbehet, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7
Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe duke zbatuar parimet e parashikuara në Rregulloren e BE-së 2016/679, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Neni 8
Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Përshkrimi teknik i numrit të ID-së për Ballkanin e Hapur dhe proceset e tij, do të përcaktohen në Protokollet shtesë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 10

Kjo marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Neni 11

Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi ose miratimi, në përputhje me procedurat e brendshme të secilës Palë Kontraktuese. Republika e Shqipërisë do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë), nga data e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga të paktën dy Palë Kontraktuese dhe do të prodhojë efekte ligjore vetëm ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Për një Palë Kontraktuese, e cila ratifikon ose miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes në fuqi në përputhje me paragrafin e dytë të këtij neni, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë), nga data e depozitimit të instrumentit të ratifikimit nga kjo Palë Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi në mënyrë të pakufizuar.

Në rast se kësaj Marrëveshjeje i kalon afati, duhet të vijojë mbrojtja e informacionit konfidencial, në përputhje me nenin 6 të saj.

Çdo Palë Kontraktuese, mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke njoftuar Depozitarin, në formë të shkruar, për qëllimin e tërheqjes. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese, në ditën e 30 (tridhjetë) nga data e marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze, duhet të depozitohet te Depozitari, i cili do të dërgojë një kopje të certifikuar te çdo Palë Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më datë njëzet e një dhjetor dy mijë e njëzetë e një.

Aleksandar Vučič
President i Republikës së Serbisë

Edi Rama
Kryeministër i qeverisë së Republikës së Shqipërisë

Zoran Zaev
President i qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

VENDIM
Nr. 70, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE
MBI KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

PREAMBULË

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si "Palët Kontraktuese" dhe individualisht si "Pala Kontraktuese",

duke shprehur vullnetin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, me synimin për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike, investimeve dhe punësimit në Ballkanin Perëndimor;

duke pasur parasysh rëndësinë e fushës së lëvizjes së punëtorëve, me qëllim sigurimin e progresit dhe prosperitetit ekonomik;

duke pasur parasysh Deklaratën e Përbashkët të nënshkruar në Novi Sad, më 10 tetor 2019, e cila bazohet në zbatimin e katër lirive themelore të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor;

duke njohur Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Ohër, më 10 nëntor 2019;

duke pranuar Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Tiranë, më 21 dhjetor 2019;

në vijim të Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëpunim, në lidhje me aksesin e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar në Shkup, më 29 korrik 2021;

duke theksuar se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se i përjashton Palët Kontraktuese nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse, sipas traktateve ekzistuese, duke përfshirë marrëveshjet e tyre ekzistuese rajonale dhe dypalëshe tregtare;

duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të përmirësuar jetën e të gjithëve brenda rajonit,

biem dakord si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shtetasit e Palëve Kontraktuese për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje, do të kenë të drejtën të lëvizin, qëndrojnë dhe punojnë lirisht brenda territorit të Palëve Kontraktuese, në përputhje me këtë Marrëveshje.

PËRKUFIZIME

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin:

1. "Shtetas" – personi që ka shtetësinë e njërës prej Palëve Kontraktuese;
2. "Legjislacion i brendshëm" – ligjet dhe aktet e tjera normative që janë në fuqi në njërën nga Palët Kontraktuese;
3. "Palë Marrëse – Pala Kontraktuese në territorin e së cilës ka hyrë, banon dhe punon shtetasi i Palës tjetër Kontraktuese;
4. "Numër ID-je i Ballkanit të Hapur" – numër unik regjistrimi për shtetasit, Palët Kontraktuese, të

krijuara nga Pala e shtetësisë së tyre, në përputhje me Marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

HYRJA, LËVIZJA, QËNDRIMI DHE PUNA

Neni 3

Palët Kontraktuese marrin përsipër të thjeshtojnë procedurat administrative për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e shtetasve të Palëve të tjera Kontraktuese.

Palët Kontraktuese garantojnë që shtetasit e Palëve të tjera Kontraktuese të kenë akses të barabartë në tregun e punës të Palës Marrëse, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe legjislacionin e brendshëm.

Neni 4

Një shtetas i njërës prej Palëve Kontraktuese, përveç të drejtave të parashikuara nga legjislacioni vendës për punën e të huajve, do të ketë të drejtën e hyrjes dhe qëndrimit për qëllime pune në Palën Marrëse në përputhje me këtë Marrëveshje, me kusht që:

1. Ai/ajo të ketë kartë identiteti të vlefshme ose dokument udhëtimi biometrik, të vlefshëm për të paktën 90 ditë deri në datën e skadimit.
2. Ai/ajo nuk është ndaluar për hyrje dhe qëndrim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.
3. Ai/ajo nuk përbën kërcënim për rendin publik, sigurinë kombëtare, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5

Një shtetasi të njërës Palë Kontraktuese që nuk plotëson kërkesat e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje do t'i mohohet aksesi i lirë në tregun e punës të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës Marrëse.

Neni 6

Një shtetas i një Pale Kontraktuese do të respektojë legjislacionin e brendshëm të Palës Marrëse kur hyn, qëndron dhe punon në territorin e Palës Marrëse.

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i rezervon të drejtën të revokojë qëndrimin në territorin e saj, një shtetasi të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Për të ushtruar të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës, një shtetas i një Pale Kontraktuese do të regjistrojë të dhëna personale dhe të dhëna të tjera, siç kërkohet nga shërbimi i duhur elektronik *online* i zhvilluar nga secila Palë Kontraktuese në përputhje me legjislacionin vendës dhe Marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

Regjistrimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të kryhet para hyrjes në territorin e Palës Marrëse, ose pas hyrjes, por jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në territorin e Palës Marrëse.

Një shtetas i një Pale Kontraktuese, që disponon një numër ID-je të Ballkanit të Hapur, do të konsiderohet se është regjistruar për akses të lirë në tregun e punës në territorin e Palës Marrëse, pasi të jetë njoftuar në mënyrë elektronike, se procedura e aplikimit ka përfunduar dhe se aksesi i lirë në tregun e punës është miratuar, i cili i jep të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës.

Miratimi i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni do t'i lejojë një shtetasi të një Pale Kontraktuese të qëndrojë në territorin e Palës Marrëse deri në 2 (dy) vjet, me mundësinë e riregjistrimit, me kusht që kushtet e përcaktuara në nenet 4 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje të jenë përmbushur.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës siguron ushtrimin e së drejtës për punësim, pa pasur nevojë të marrë një leje pune dhe qëndrimi në Palën Marrëse, duke përfshirë përjashtimin e tarifave të aplikimit, sipas legjislacionit vendës.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës në Palën Marrëse përjashton të drejtën për stimuj shtetërorë të punësimit, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Nëse një shtetas i një Pale Kontraktuese të cilit i është miratuar aksesi i lirë në tregun e punës në Palën Marrëse, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ndryshon ndonjë nga të dhënat e regjistruara përmes shërbimit elektronik *online* të Palës Marrëse, ai/ajo do ta raportojë këtë informacion pa vonesë nëpërmjet atij shërbimi elektronik *online*.

Neni 8

Në rast se aplikimi për akses të lirë në tregun e punës nuk është miratuar, do të zbatohet legjislacioni i brendshëm i Palës Marrëse, për të cilin aplikanti do të njoftohet në mënyrë elektronike.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qeni i vlefshëm, nëse qëndrimi në territorin e Palës Marrëse të një shtetasi të një Pale Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, anulohet më pas, në rast se më pas zbulohet se miratimi për akses të lirë në tregun e punës është lëshuar në bazë të informacionit të rremë ose në fshehje të informacionit për qëllimin dhe rrethanat aktuale të punësimit, ose nëse arsyet për të cilat është dhënë miratimi për akses të lirë në tregun e punës, kanë pushuar së ekzistuari.

Neni 9

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohen, në lidhje me përmbushjen e kërkesave për aplikimin për qëndrim të përhershëm në Palën Marrëse.

Një shtetas i Palës Kontraktuese, që synon të aplikojë për qëndrim të përhershëm në Palën Marrëse, do të jetë i detyruar të veprojë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të asaj Pale Marrëse.

Neni 10

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk zbatohen për shtetasit që hyjnë ose qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për qëllime turizmi ose qëllime të tjera që nuk lidhen me aksesin e lirë në tregun e punës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Megjithatë, shtetasit e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk përjashtohen nga përdorimi i kësaj Marrëveshjeje, nëse dëshirojnë të aplikojnë për akses të lirë në tregun e punës, në përputhje me nenin 7, paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje.

KOMITETI I PËRBASHKËT

Neni 11

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të krijohet një komitet i përbashkët i ngarkuar me organizimin, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Komiteti i Përbashkët do të përbëhet nga të paktën pesë përfaqësues të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 13

Komiteti i Përbashkët do të mblidhet të paktën një herë në vit dhe do t'u raportojë Palëve Kontraktuese çdo gjashtë muaj për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Komiteti i Përbashkët do të zhvillojë mbledhjen e tij të parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Komiteti i Përbashkët, në mbledhjen e tij të parë, miraton rregullat e tij të procedurës.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Palët Kontraktuese marrin përsipër të harmonizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm me *acquis* të BE-së për çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

Çdo çështje që nuk rregullohet nga kjo Marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i Palës Marrëse.

Neni 16

Palët Kontraktuese bien dakord që protokollet shtesë mund të rregullojnë më tej çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht çështjet që lidhen me sistemin e informacionit që mundëson regjistrimin, si dhe çështjet që lidhen me qëndrimin, lëvizjen dhe punën e shtetasve në territorin e Palës Marrëse.

Protokollet do të lidhen nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 17

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 18

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga traktate të tjera ndërkombëtare në të cilat janë palë.

Palët Kontraktuese bien dakord që të lidhet një marrëveshje për sigurimet shoqërore.

Neni 19

Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit në përputhje me procedurat e brendshme të secilës Palë Kontraktuese. Republika e Shqipërisë do të veprojë si Depozitar e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga të paktën dy Palë Kontraktuese dhe do të prodhojë efekt ligjor vetëm ndërmjet këtyre Palëve Kontraktuese.

Për një Palë Kontraktuese që ratifikon ose miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit nga ajo Palë Kontraktuese.

Me kusht që kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, zbatimi i saj do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, të lidhur nga të njëjtat Palë Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve Kontraktuese.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar.

Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke e njoftuar depozitarin me shkrim, për synimin e saj për t'u tërhequr. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese në ditën e 30 (tridhjetë) pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet te Depozitari, i cili do t'i dërgojë një kopje të vërtetuar secilës Palë Kontraktuese.

Bërë në Tiranë në datën njëzet e një dhjetor, dy mijë e njëzet e një.

Aleksandar Vučić
President i
Republikës së Serbisë

Edi Rama
Kryeministër i
Qeverisë së
Republikës së Shqipërisë

Zoran Zaev
President i Qeverisë së Republikës së
Maqedonisë e Veriut

VENDIM
Nr. 71, datë 2.2.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA PUNONJËSIT DHE ISH-PUNONJËSIT E RAFINERISË SË NAFTËS, BALLSH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie pagese kalimtare, në masën e pagës minimale në shkallë vendi, për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh, pas verifikimit nga zyra përkatëse e punësimit të listës emërore, sipas vendimit nr. 909, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh", të ndryshuar, për çdo muaj, për periudhën janar 2022–dhjetor 2022.

2. Punonjësve, sipas pikës 1, të këtij kreu, t'u paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për pjesën e punëmarrësit e të punëdhënësit për periudhën janar 2022–dhjetor 2022, duke iu transferuar fondi përkatës Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të

Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Pagesa kalimtare për punonjësit, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, jepet çdo muaj për periudhën janar 2022–dhjetor 2022, pranë zyrës së punësimit, ku kanë vendbanimin.

2. Pagesa kalimtare përfitohet nga punonjësit, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, pavarësisht nëse kanë përfituar apo jo më parë ndihmë financiare.

3. Pagesa kalimtare u jepet punonjësve sipas listës së miratuar me vendimin nr. 909, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh", të ndryshuar, pas verifikimeve nga zyra përkatëse e punësimit, duke përjashtuar nga përfitimi personat që:

a) janë të punësuar apo vetëpunësuar;

b) kanë dalë në pension pleqërie apo invaliditeti;

c) nuk janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

4. Punonjësit kërkues duhet të paraqesin pranë zyrës përkatëse të punësimit të dhënat e mëposhtme identifikuese, si:

i. emrin, mbiemrin;

ii. numrin personal të identifikimit;

iii. llogarinë bankare, në të cilën ka marrëveshjen zyra e punësimit;

iv. IBAN-in e llogarisë bankare.

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e kërkesës, bën verifikimet përkatëse në sistemin tatimor mbi të dhënat e deklaruara nga kërkuesit.

2. Zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve të çdo muaji, gjatë periudhës së përfitimit, bën verifikimet sipas pikës 1, të këtij kreu, përpilon listat përmbledhëse të përfituesve, të ndara për çdo bankë të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë rrjedhëse bankare, të cilat i dërgon pranë bankës së nivelit të dytë. Lista duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin, mbiemrin e përfituesit;

b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) bankën ku ka marrëveshjen zyra përkatëse e punësimit;

ç) IBAN-in e llogarisë bankare;

d) masën e pagesës.

3. Zyra përkatëse e punësimit ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar sipas këtij vendimi, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Fondi prej 420 000 000 (katërqind e njëzet milionë) lekësh përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2022 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht në zërin "Pagesa e papunësisë", të programit buxhetor 10550 "Tregu i punës".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 72, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2022, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

SHTOJCA NR. 1
PEMA E PROGRAMIT TE ASHK-SË PËR
VITIN 2022



SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS 2022

000/lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti Janar- Dhjetor 2022	
	Të Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndertimore	5.244.578	
Fonde te akorduara nga buxheti i shtetit	652.000	
Shpenzime personeli		2.280.151
Shpenzime korente		720.000
Transferta per Qendrën e Kadastrës Dixhitale		652.000
Shpenzime kapitale		1.379.148
Fondi rezervë		104.700
Total	**5.896.578**	**5.135.999**
Teprica (1)-(2)		**760.579**

SHTOJCA NR. 3
BUXHETI I AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS 2022

000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI JANAR - DHJETOR 2022
I	**TOTALI I TË ARDHURAVE**	**5.896.578**
1	Të ardhura nga shërbimet	1.800.000
2	Të ardhura nga transferimi I parcelës ndërtimore	300.000
3	Të ardhura të tjera	280.000
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2021	2.864.578
5	Fonde te akorduara nga buxheti I shtetit	652.000
II	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**5.135.999**
1	**Shpenzime personeli**	**2.280.151**
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1.320.046
2	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjesit në organikë	219.837
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	577.778
4	Kontribute për Sigurime Shoqerore për punonjësit me kontratë	96.489
5	Fondi i vecantë i pagave	66.002
2	**Shpenzime operative**	**720.000**
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570.000
